

VENDIM
Nr. 363, datë 5.6.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 279, DATË 12.5.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT SOCIAL-KULTUROR, PALLATI I
KULTURËS, BASHKIA SHIJAK, DHE CAKTIMIN E BASHKISË SHIJAK SI NJËSI
ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/3, të vendimit nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/4, me këtë përmbajtje:

“2/4. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, nga fondet e rindërtimit, miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 37 496 534 (tridhjetë e shtatë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku